REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 944/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINE - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr i prokurimit	**613-20-5228-1-2-1**
Nr i brendshëm	**613 020 100 121**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"IDEA EET" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Adem Jashari" p.n. Duhël
(Adresa)

Suharekë-Kosovë
(Vendi)

23000
(Kodi postar)

044186774
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Avni Elshani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ideaeetshpk01@gmail.com
(Adresa elektronike)

14.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëria me përgjegjësi e kufizuar IDEA EET SH.P.K. SUHAREKË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoritetit Kontraktues njoftimin për kontratë e ka publikuar me dt. 25.09.2020. Njoftimi B58 për vendimin e Autoritetit Kontraktues është publikuar me datën 06.11.2020. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit ka qenë me datë 16.10.2020 ora 14:00. Hapja e tenderit është bërë me datë 16.10.2020 ora 14:00, Kriteri për dhënien e kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk kemi marrë pjesë në hapjen e tenderit por pasi që na është dërguar procesverbali i hapjes nuk kemi pasur ndonjë vërejtje andaj konsiderojmë që procesi i hapjes ka qenë në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

Autoriteti kontraktues me datë *06.11.2020 ka publikuar njoftimin B58 për vendimin e Autoritetit Kontraktues si dhe letrën standarde për eleminimin tonë si tender i pa përgjegjshëm.*

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Autoriteti kontraktues me datë *06.11.2020 ka publikuar njoftimin B58 për vendimin e Autoritetit Kontraktues si dhe letrën standarde për eleminimin tonë si tender i pa përgjegjshëm. Të pa kënaqru me vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me vlerësimin e këtij tenderi, me datë 07.11.2020 përmes platformës elektronike kemi parqitur kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktes Kuvendi Komunal Lipjan. Edhe për kundër se ne i kemi paraqitur të gjitha faktet dhe argumentet tona se na është bërë e pa drejtë për shkak se jemi eleminuar në këundrshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë, Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë për bazë faktet dhe argumentet tona por pa kurrëfarë arësyetimi me datë 11.11.2020 e refuzon si të pa bazë kërkesën tonë për rishqyrim.*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues gjatë kësaj procedure ka shkelur dispozitat e legjislacionit të prokurimit si në vijim:
Neni 1 i LPP-s Qëllimi
Neni 7 i LPP-s Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 60 i LPP-s Kriteret për dhënien e kontratës
Neni 59 i LPP-s Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 108/A i LPP-s Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Neni 38 i RROUP-s Mostrat e Tenderëve
Neni 39 i RROUP-s pika 39.6 Sqarimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Pas njoftimit për kontratë nga Autoriteti Kontraktues ne kemi shprehur interesin që të aplikojmë në këtë tender. Me datën 16.10.2020 ora 13:15 kemi dorëzuar tenderin tonë përmes platformës elektronike duke ja bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana Autoritetit Kontraktues në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Gjatë vlerësimit të tenderit me datë 30.10.2020 kemi pranuar një kërkesë për sqarimin e tenderit jo normalisht të ulët nga Autoriteti Kontraktues Komua e Lipjanit. Pas analizimit të kërkesës, me datë 31.10.2020, ua kemi dërguar sqarimin tonë në të cilin në mënyrë profesionale ua kemi dhën shpjegimet tona se si kemi ardhur deri te çmimi i ofertës tonë dhe kemi konfirmuar se do të mbetemi pranë ofertës, duke i plotësuar në tërësi specifikat teknikike. Me datë 04.11.2020 përsëri kemi pranuar një shkresë për sqarimin e tenderit me të cilën AK ka kërkuar mostrat për maska dhe dezinfektues.
Edhe pse kërkesa e tyre ka qenë me një afat shumë të shkurtër kohor, ne ua kemi ofruar mostrat tona të cilat me përpikmëri i kanë plotësuar specifikat teknike në dosje të tenderit dhe përshkrim të çmimit. Por është për habi fakti se në letrën standarde për eleminimin tonë, AK ks cekur se kinse mostrat e dorëzuara nuk i përmbushin standardet sipas specifikimeve teknike që i ka përcaktuar autoriteti kontraktues.

Pasi kemi pranuar vendimin e AK-s për dhënie të kontratës, kemi parë që ka shpërblyer me kontratë një O.E. i cili e ka dorëzuar ofertën me çmim më të lartë se oferta jonë. Neni 1 i LPP-s ka përcaktuar që: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë". Në bazë të kësaj dispozite ligjore, autoritet kontraktuese janë të obliguar që të sigurohen që të marrin vlerën për paranë. Por AK duke i shkelur dispozitat në fjalë ka shpërblyer me kontratë një O.E. i cili ka ofruar çmimin më të lartë se oferta jonë.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, Autoriteti Kontraktues kriter të dhënies së tenderit ka paraqitur "Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët" por në realitet e ka shpërblyer me kontratë një O.E. me çmim më të lartë se oferta jonë, andaj kjo paraqet shkelje të dispozitave të nenit 60 të LPP-s.

Mostrat e dorëzuara nga ana jonë janë në përputhshmëri me kërkesat e aneksit I të dosjes së tenderit, andaj pretendimi i AK-s se kinse mostrat e dorëzuara nga ana jonë nuk i përmbushin standardet sipas specifikimeve teknike që i ka përcaktuar autoriteti kontraktues, është vetëm një pretekst fiktiv për të na eleminuar nga konkurrenca, pasi që ka dashur që përmes eleminimit tonë të shpërblen me kontratë një O.E. me çmim më të lartë. Andaj ky veprim paraqet shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-s pasi që AK nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese operatorët ekonomik.

Për më tepër, në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë AK nuk ka kërkuar që të dorëzohen mostrat. Në nenin 38 të RROUP është paraparë që nëse një autoritet kontraktues kërkon të sillen mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet te dorëzohen para afatit te fundit për dorëzim te tenderëve. Pra kjo dispozitë e ka përcaktuar qartë se mostrat duhet të kërkohen para dorëzimit të tenderit si dhe shprehmisht e ka cekur se si duhet të trajtohet një mostër. Autoriteti Kontraktues ne letren standarde nuk na ka dhënë kurrfar sqarimi se pse mostrat tona nuk i kane plotesuar specifikat, cila nga mostrat ka pasur ndonjë mangësi? Kush i ka bërë testet e këtyre mostrave? Andaj duke vepruar në këtë mënyrë konsiderojmë se ka shkelur edhe dispozitat e nenit 38 të RROUP. Gjithashtu gjatë vlerësimit të tenderit Autoriteti Kontrakteues ka shkelur edhe nenin 39 të RROUP-s pika 39.6 pasi që ka kërkuar që mostrat të dërgohen brenda një kohe shumë të shkurtër, më pak se 6 orë. Pra nuk na ka dhën kohë të mjaftueshme sikur është cekur në dispozitat e këtij neni.

Dispozitat e nenit 59 të LPP-s në paragrafin 4 kanë përcaktuar sakt se: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Kjo dispozit nënkupton se Autoriteti Kontraktues nuk mund të shton kërkesa tjera gjatë vlerësimit të tenderit, por vlerësimi duhet të bëhet në bazë të atyre kërkesave të cilat i ka paraqitur në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Mostrat e tenderit, nuk janë kërkuar nga ana e AK-s në dosje të tenderit dhe as në njoftimin për kontratë andaj eleminimi jonë për një kërkes të tillë paraqet shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-s.
Autoriteti Kontraktues ka bërë edhe shkelje gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të paraqitur nga ana jonë. Edhe pse në kërkesë kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, që automatikisht të pezullon procedurën e prokurimit për shkak se pretendimet tona janë të bazuara, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë një gjë të tillë. Duke vepruar në këtë mënyrë AK ka bërë edhe shkelje të dispozitave të nenit 108/A paragrafi 2 i LPP-s si dhe dispozitave të nenit 6 paragrafi 6.1 të Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

Andaj, duke u bazuar në faktet dhe argumentet e cekura më lartë, kërkojmë nga ana juaj që të urdhëroni Autoritetin Kontraktues që automatikisht të pezullon procedurën e prokurimit, pas shqyrtimit të ankesës tonë të njejtën ta aprovoni si të bazuar dhe të anuloni vendimin e AK-s për dhënie të kontratës dhe lëndën ta ktheni në rivlerësim ta urdhëroni Autoritetin Kontraktues që të eleminon shkeljet e cekura më lartë dhe të na shpërblen me kontratë neve si operator të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Për përgatitje të tenderit në fjalë janë shkaktuar shpenzime të ndryshme, të cilat kanë ndikuar në pasqyrat tona finaciare. Duke pasur parasysh se është shpërblyer me kontratë një O.E. me çmim më të lartë se oferta jonë, vjen në shprehje fitimi i humbur në vlerë të ofertës tonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*